

COVID-19

Newsflash

Masa të tjera në Shqipëri, 23 mars 2020

Klikoni [këtu](#) për masat e ndërmarra deri më 19 Mars 2020

Lëvizja në këmbë

Autoritetet kanë njoftuar ndryshimin e orarit të lëvizjes në këmbë. Duke nisur nga e hëna, datë 23 mars 2020, individët mund të lëvizin në këmbë vetëm përgjatë orarit **05:00- 13:00**.

Ky do të jetë edhe orari i pikave të shitjes së ushqimeve, ilaceve apo shërbimeve bankare, si dhe orari i punës së punojnësve të administrates.

Ndalohen fluturimet

Krashes fluturimeve me Italinë dhe Britaninë e Madhe, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka urdhëruar ndalimin e të gjitha fluturimeve drejt dhe nga:

- Gjermania;
- Austria;
- Zvicra;
- Hungaria;

Ky urdhër do të mbetet në fuqi deri në një njoftim të mëtejshëm.

Shpërndarja e dokumentacionit tatimor

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar se tërheqja e dokumentacionit tatimor (bllaqe faturash TVSH, Model 4, dëftesa tatimore etj) do të vijojë të kryhet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku ata janë të regjistruar, gjatë orarit zyrtar të punës, e **hënë- e premte 08:00-13:00**.

Përcaktimi i subjekteve që do të lejohen apo ndalohen të kryejnë aktivitet ekonomik.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar listën e aktiviteteve që do të lejohen apo do të ndalohen të ushtrjnë aktivitet ekonomik. Duke filluar nga data 24 Mars 2020:

Do të lejohen të vazhdojnë ushtrimin e aktivitetit të gjithë tatimpaguesit që kryejnë aktivitet në fushën e prodhimit bimor dhe shtazor, përpunimin e produkteve ushqimore, prodhimeve të drurit, prodhimit të tekstileve, prodhimit të produkteve kimike, produkteve farmaceutike, prodhimit të mineraleve, prodhimit të produkteve elektronike, prodhimit të produkteve elektrike, prodhimit të mobiljeve etj.

Do të ndalohet ushtrimi i aktiviteteve në ambjente që ofrojnë shërbime, lokale nate, ambjente të mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve, aktivitete palestra, qendra sportive, pishina, qendra interneti, qendra kulturore dhe qendra argëtimi, të njësisve të shitjeve në të gjitha Qendrat Tregtare si dhe çdo njesie tjetër që kryhen shitje me pakicë të artikujve: industriale, kulturore, veshjeve të llojeve të ndryshme, mallrave artistike, sportive dhe kozmetike.

Klikoni [këtu](#) për më shumë detaje.

Plani financiar

Në datën 19 mars 2020, qeveria prezantoi publikisht planin financiar në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Disa nga masat e prezantuara më poshtë hynë në fuqi me Aktin Normativ Nr.6, datë 21.3.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 88/2019, për buxhetin e vitit 2020". Megjithatë, priten detaje të mëtejshme mbi planin financiar, si dhe për masat e prezantuara në lidhje me afatin e dorëzimit të bilanceve apo tatim fitimin e riskeduluar duke filluar nga 6-mujori i dytë.

- Strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë i alokohen **2.5 miliardë lekë**, me qëllim pajisjen e institucioneve dhe personelit me materiale mjekësore ose mbështetjen e stafeve mjekësore.
- Në funksion të shoqërive tregtare, të cilat objektivisht kanë paaftësi paguese të pagave të punonjësve, vendoset një fond prej **10 miliardë lekë**, përmes instrumentit të një garancie sovrane.
- Vendosja e **6.5 miliardë lekë** në kuadër të përmbushjes së nevojave më urgjente të shtresave së mëposhtme:
 - Biznesi i vogël;
 - Shtresat në nevojë;
 - Papunësia e mundshme si pasojë e situatës aktuale.
- Ministrisë së Mbrojtjes i vihen në dispozicion **2 miliardë lekë** në funksion në Operacionit Humanitar.
- Krijimi i një fondi rezervë prej 1 miliardë lekë, në dispozicion të Këshillit të Ministrave si përgjigje ndaj cdo nevoje urgjente që mund të lind përgjatë situatës aktuale.
- Kamatvonesat për debitorët aktivë (familjarë apo biznes i vogël) të cilët aktualisht kanë konsum energji do të fshihen, me efekt financiar deri në 15 miliardë lekë.
- Riskedulimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2020, dhe në vazhdim, i tatim fitimit për biznesin i cili përket në fashën 2 - 14 milionë lekë xhiro.
- Afati i dorëzimit të bilanceve online apo drejtë për drejtë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i.e. QKB) nga bizneset përkatëse, shtyhet deri në 1 qershor 2020.

www.pwc.com/al. Ky informacion ka për qëllim një përditësim të përgjithshëm për personat e interesuar dhe nuk duhet të përdoret si bazë për vendimarrje. Për detaje të mëtejshme, ju lutem të kontaktoni PwC Albania në: pwc.albania@al.pwc.com.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. PwC i referohet firmës anëtare shqiptare, dhe ndonjëherë mund t'i referohet edhe rrjetit PwC. Çdo firmë anëtare është një entitet juridik i veçantë. Ju lutem të shikoni www.pwc.com/structure për detaje të mëtejshme.